

Të zgjedhurit e popullit të Kosovës, para shtatë vitesh patën shpallur pavarësinë e vendit duke e realizuar kështu një ëndërr të madhe të kosovarëve dhe duke rritur shpresat e tyre për krijimin e një shteti që do të garantonte për ta jetë të dinjitetshme.

Mirëpo, tani pas shtatë vitesh, shpresat e një pjese të madhe të kosovarëve duket se janë shuar, pasi besohet se në kohët e fundit mbi 230 mijë shtetas të Kosovës e kanë braktisur vendin duke migruar në drejtim të vendeve evropiane, si pasojë e mungesës së zhvillimit ekonomik dhe mungesës së perspektivës për një jetë të dinjitetshme në këtë shtet. /Zëri/